

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 16.09.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “ulje e pagës deri në 40%, deri në 1 vit” ndaj gjyqtarës P.F.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka finalizuar hetimin disiplinor ndaj magjistrates P.F. me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, bazuar në praktikën e nisur ndaj magjistrates në vitin 2017 nga Inspektoriati i KLD-së dhe e përcjellë, me kërkesë të ILD-së nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kontekst: Hetimi disiplinor ndaj magjistrates P.F. nisi pas publikimit, më 31.01.2017, në emisionin investigativ “STOP” të TV Klan, të fakteve që cenonin rëndë figurën dhe pozitën e saj si gjyqtare, ku pretendohet se ajo, kundrejt një shume monetare, kishte marrë përsipër të aplikonte dënimin minimal ndaj një të pandehuri të paraburgosur. Në vijim, Prokuroria për Krimet e Rënda nisi procedim penal dhe ndaj magjistrates u vendos masa e sigurimit “Pezullimi i një detyre apo shërbimi publik”. Për këtë arsye, KLD e kohës e pezulloi nga detyra dhe pezulloi edhe hetimin disiplinor deri në përfundimin e procedimit penal. Pas pushimit të hetimeve nga Prokuroria, me vendimin e datës 20.07.2017, hetimi disiplinor u riaktivizua për sjellje dhe veprime që diskreditonin pozitën dhe figurën e gjyqtarit. Në fokus të hetimit ishte edhe përdorimi nga magjistratja i shprehjes “predispozicion pozitiv për zgjidhjen e çështjes”, e vlerësuar si e papërshtatshme për një gjyqtar, pasi krijonte perceptimin e mungesës së paanshmërisë dhe cenonte figurën morale të gjyqtarit. Raporti i hetimit iu përcoll Ministrit të Drejtësisë për vlerësimin e fillimit të procedimit disiplinor, por kjo kompetencë nuk u ushtrua. Dokumentacioni përkatës iu përcoll më pas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në dhjetor 2020.

Me administrimin e dosjes nga Ministria e Drejtësisë e më pas edhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka konkluduar se hetimi ndaj magjistrates ishte i paplotë, prandaj vendosi vijimin e hetimit për të njëjtën shkelje disiplinore. Në përfundim, në analizë të fakteve raporti i hetimit i ILD konkludon se:

- Magjistratja ka kryer veprime që përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke shkelur rregullat e solemnitetit, të sjelljes me palët dhe duke zhvilluar komunikime ex parte me dy persona të paraqitur si familjarë të të pandehurit.
- Komunikimet kanë qenë të qëllimshme dhe të përsëritura, pa u provokuar nga personat përkatës. Gjyqtarja ka dhënë vullnetarisht informacion mbi ecurinë dhe përfundimin e pritshëm të çështjes, përfshirë çështjen e dënimit, shtyrjen e gjykimit, përfitimin e të pandehurit dhe masat për zëvendësimin e prokurorit.
- Këto veprime kanë cenuar prestigjin e figurës së gjyqtarit dhe besimin e publikut te drejtësia, duke prekur parimet themelore të paanshmërisë dhe integritetit të gjyqësorit.
- Pavarësisht 28 viteve përvojë si gjyqtare, magjistratja nuk ka treguar kujdesin dhe vetëpërmbytjen e kërkuar nga detyra, duke krijuar perceptimin e një zgjidhjeje pozitive të çështjes, në vend të një vendimmarrjeje të drejtë dhe të paanshme.

Për sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon KLGJ-së caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, ndaj magjistrates P.F., parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Shënim: Sic është bërë e ditur, për të shmangur kulturën e pandëshkueshmërisë dhe harresës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë po shqyrton praktikat e trajtuara pjesërisht nga ana e organeve të mëparshme, për shkak të kompetencave të kufizuara e të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare. ILD po e kryen këtë proces përmes një metodologjie të posaçme, sipas një radhe përparësie të bazuar në kritere si: data e dorëzimit, faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare.